



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM
Nr. 68 datë 21.12.2022**

“PËR MIRATIM TË VLERËSIMIT PARAPRAK DHE MASA E SHPËRBLIMIT PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN PËR EFEKT INVESTIMI PUBLIK TË OBJEKTIT “RIKONSTRUKSION RRUGA I QERSHORI“

Këshilli i Bashkisë Shkodër në mbledhjen e tij të dt. 21.12. 2022 ,në mbështetje të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore“ i ndryshuar, ligjit Nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të perkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik,,të ndryshuar, VKM-së Nr. 127, datë 23.3.2000 “Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të perkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik,, VKM-së Nr.89, date 3.2.2016 “Për miratimin e vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, pasi shqyrtoi relacionin me pasqyrat përkatëse të paraqitur nga komisioni i ngritur me urdhër nr.1019, dt.025.11.2022 “Për ngritjen e komisionit të vlerësimit paraparak të pasurive pronë private që shpronësohen për efekt investimi publik për objektin “Rikonstruksion Rruga I Qershori“, si dhe relacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër:

V E N D O S I:

1. Të miratojë vlerësimin paraparak dhe masen e shpërblimit për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme (truall), pronë private, që preken për efekt investimi publik të objektit “Rikonstruksion Rruga I Qershori,, me vlerë 2 285 701 lekë dhe tabelen bashkëlidhur .
2. Fondi i shpronësimit prej 2 285 701 do të parashikohet në buxhetin e bashkisë Shkodër programi 04520 “Rrjeti rrugor rural,,.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet komisioni.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

KRYETAR


Brisela KADIJA



Sekretari i Këshillit Bashkiak



Denis Lesha

Miratuar me 30 vota

Vota Pro 30

Vota Kunder 0

Vota Abstenim 0

Zbardhur me datë 23.12.2022